

Informacione Detyruese

Informacioni Detyrues i Tarifës (IDT)

Informacioni Detyrues i Origjinës (IDO)

Standartizimi i aplikimit per Informacion të detyrueshem tarifor

Klasifikimi tarifor i një produkti përbën informacion thelbësor.

Kodifikimi i mallrave përdoret jo vetëm për të përcaktuar nivelin e tarifës doganore, ai përdoret gjithashtu për të aplikuar masa jo tarifore.

Kështu, edhe nëse të gjitha mallrat janë me takse doganore 0, kodifikimi tarifor ka përsëri rëndësi përse i përket çertifikatës së origjinës, përjashtimeve nga TVSH, zbatimit të kufizimeve të importit ose eksportit, etj.

Në rastin e klasifikimit tarifor të mallrave ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga çdo degë doganore, në mënyre të unifikuar dhe pa u kundërshtuar, nëse lëshohet brenda kuadrit të Informacionit të Detyrueshëm Tarifor.

Kushtet kryesore për marrjen e një IDT janë:

- **Aplikimet për IDT** duhet të lidhen **me një produkt**. Mallrat të cilat kanë karakteristika të ngjashme mund të pranohen si një produkt, me kusht që dallimet të jenë të parëndësishme për qëllimet e përcaktimit të klasifikimit të tyre tarifor, p.sh.' vazo balte për lule' me dimensione të ndryshme.
- Lëshimi i një vendimi IDT është **pa pagesë**, megjithatë, në përputhje me Nenin 53 (2) (b) të Kodit Doganor mund të vendosen tarifa lidhur me analiza ose raporte të ekspertëve për mallra dhe tarifa postare me qëllim kthimin e mallrave tek aplikuesi i IDT.
- Periudha e vlefshmërisë për një vendim IDT është **tre vjet**.
- **IDT është e detyrueshme** për t'u zbatuar si për **administratën doganore dhe për mbajtësin** e tij.

Formatet për aplikimin për Informacionit të Detyrueshem Tarifor dhe ai i Vendimit të Informacionit të Detyrueshëm Tarifor do të jenë tashme të standardizuara me BE dhe do të publikohen në webin e ADSH.

Informacioni Detyrues i origjinës

- IDO është një vendim ligjor i cili jipet nga DPD, lidhur me origjinën e mallrave, bazuar në aplikimin e operatorit ekonomik.
- IDO i referohet vetëm një lloj malli dhe një grupi rrethanash për përcaktimin e origjinës.
- Nuk ka efekt detyrues jashtë territorit të R.Sh.
- IDO është e vlefshme për një periudhë 3-veçare nga data e lëshimit.
- Dogana mund t'a anullojë apo revokojë vendimin IDO.
- IDO mbi origjinën e mallrave **nuk zëvendëson provat e origjinës së mallrave**. Ato do të kërkohen dhe paraqiten në Doganë në import apo eksport.

Avantazhet e IDO

- Ndhmon kur një rregull origjine është i vështirë për t'u interpretuar;
- Jep siguri më të madhe dhe lejon të planifikosh;
- Ligjërisht je i mbrojtur përkundrejt Autoriteteve Doganore;
- Vazhdimësia e përdorimit të një IDO të pavlefshme si pasojë e ndryshimeve në kuadrin ligjore, edhe për 6-muaj të tjerë;
- Informim nëse ka ndryshime në lidhje me rregullat e origjinës;
- Lëshimi i një vendimi IDO është pa kosto

Deklaratat e Furnitorit (DF)

- Është mundësia e vetme që një furnitor të deklarojë origjinën e mallrave për eksportuesin apo tregtarin.
- Është **një evidencë**, e cila shërben si mbështetje e kërkesave për lëshimin ose bërjen e provave të origjinës (Certifikatë e OJP, Form A, Certifikatë lëvizëse EUR. 1 apo Deklaratë-Faturë)
- **Kërkesat**
- Teksti i DF është detyrues dhe në përputhje me Dispozitat e KD apo Konventës Rajonale PEM
- Një DF mund të lëshohet në faturë, në notën shpërndarëse apo në ndonjë dokument tjetër tregtar
- nuk është e nevojshme një formë e para-printuar e saj
- Firma Originale

Deklaratat e Furnitorit (DF)

Kategoritë

- **DF për produktet që kanë status së origjinës preferenciale :**
 - tërësisht të prodhuara
 - të punuar ose të përpunuar mjaftueshëm nga materiale jo-origjinuese
- **DF për produktet që nuk kanë status së origjinës preferenciale**
 - të punuar ose të përpunuar **jo** mjaftueshëm nga materiale jo-origjinuese

Tipet

- **DF e ndarë**
 - Për çdo ngarkesë individuale të produkteve
- **DF Afat-Gjatë**
 - DF e vetme për të mbuluar dërgesat e mëvonshme të mallrave.
 - Deklarata afatgjatë e një furnitorit mund të bëhet për një periudhë vlefshmërie deri në 2 vjet nga data në të cilën ajo është bërë, ose, ajo mund të bëhet edhe për një periudhë vlefshmërie deri në 1 vit përpara datës në të cilën deklarata është bërë.